



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË
PUBLIKE TË KOSOVËS


NATIONAL INSTITUTE OF PUBLIC HEALTH
OF KOSOVA



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË SEZONALE DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2024/2025 (JAVA 52-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2020/2021 - 2024/2025

Sipas grafikorit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2024/2025 karakterizohet me numër afërsisht të njëjtë të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2023/2024 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të, 2024/2025 (Graf.1).

Grafikoni.1




SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2024/2025 DHE PRAGU EPIDEMIK

Nga fillimi i sezonës, 30 shtator 2024 deri më 29 dhjetor 2024 (java e 52-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 31,677 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 4,830 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 64 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 52-të (23.12.2024-29.12.2024) janë raportuar 3,313 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 187 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 2 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 52-të paraqitet në aktivitetin e mesëm të lartë të qarkullimit dhe krahasuar me javën paraprake shënon rritje prej 10%.(Graf.2)

Grafikoni.2



Në grafikonin 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Grip dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Gjiljanit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Prishtinës, Kamenicës dhe Hanit të Elezit. (Graf.3).

Grafikoni.3



MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2024/2025 deri me 31 dhjetor 2024, janë testuar gjithsej 1,581 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 792 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 789 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë.


Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 10 prej tyre (1.26%).

Nga 789 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 95 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 12.04 %). Sipas tipit: me Influcencë A (86 raste apo 10.9%) dhe Influcencë B (9 raste apo 1.14%), sipas komunave: komuna e Prishtinës (50 raste), Fushë Kosovë (12 raste), Vushtrri (9 raste), Podujevës (5 raste), Malishevës (3 raste), Lipjanit (3 raste), Obiliq (3 raste), Pejë (2 raste), Istog (2 raste), Drenas (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Rahovec, Skenderaj, Mitrovicë, dhe Gjilan kurse sipas grup-moshës: 0-4 vjeç (43 raste), 5-14 vjeç (22 raste), 15-29 vjeç (12 raste), 30-44 vjeç (4 raste), 45-60 vjeç (5 raste) dhe 60+ (9 raste).

Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 67 mostra me RSV, 64 mostra me Human Rhinovirus, 42 mostra me Human Adenovirus, 8 mostra me Parainfluenza Virus dhe 1 mostër Metapneumovirus.


Nga 67 rastet pozitive në RSV (8.49%): 57 prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 8 raste i takojnë grup-moshës 5-14 vjeç dhe 2 raste i takojnë grup-moshës 65+ vjeç kurse sipas komunave: Prishtinë (38 raste), Podujevë (9 raste), Fushë Kosovë (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Lipjan (3 raste), Gjilan (2 raste), Vushtrri (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Drenas, Ferizaj, Gjakovë, Skenderaj, Kaçanik dhe Obiliq.

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 83 raste (87%), me subtipin AH3 janë 3 raste (3%), Influcencë B Victoria, 1 rast (1 %) dhe Influcencë B të pasubtipizur janë 8 raste (9%).

Grafikoni.6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20),

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike dhe punëtorët shëndetësor që të ngrisin nivelin e vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë.

Ka rekomanduar tek Inspektorati shëndetësor dhe sanitar të mbikëqyrë të gjitha Institucionet shëndetësore të Kosovës, për të urdhëruar për obligimin ligjor të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse dhe rasteve të vdekjeve nga këto sëmundje.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit është në nivel mesatar krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe huthja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Vaksinimi kundër gripit sezonal bëhet në muajt tetor–dhjetor.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori deri me 30 nëntor janë administruar 61,467 doza. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 41,420 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 18,425 me sëmundje kronike, 1,598 profesionistë shëndetësor, 3 gra shtatëzëna dhe 21 fëmijë (0-5 vjeç).

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 41 raste me ARI, 6 raste me ILI dhe 2 raste me SARI.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 51/2024 NË EVROPË

Numri i pacientëve që paraqiten në kujdesin parësor dhe spitale për infeksione të traktit respirator mbetet në nivelet e pritura për këtë periudhë të vitit, përderisa aktivitetet e virusit të Influcencës dhe virusit respirator sinticial (RSV) vazhdojnë të rriten në BE/ZEE.

Aktiviteti i virusit të Influcencës është në rritje prej katër javësh, me shkallën e përgjithshme të pozitivitetit të testimit në kujdesin parësor në BE/ZEE në 12%.

Epidemia e Influcencës ka nisur zyrtarisht në të gjitha pjesët e BE/ZEE. Ndërsa shtrimet në spital për shkak të Influcencës janë vërejtur në të gjitha grupmoshat. Virusi i gripit B dominon aktualisht në Spanjë, Portugali dhe Sllovakia.

Aktiviteti i RSV është rritur për gjashtë javë me rradhë, me normën totale të pozitivitetit të testimit në kujdesin parësor në BE/EEA në 9%. Që nga java e 40-të, 80% e rasteve të shtruara në spital me RSV janë fëmijë prej ku 57%, fëmijë të moshës nga 6 muaj deri në 2 vjeç dhe 13% janë të rritur të moshës 65 vjeç e lart.

Aktiviteti i SARS-CoV-2 pas një piku të arritur në korrik, gradualisht është ulur në shumicën e vendeve të BE/EEA që përjetuan një valë epidemike gjatë verës. Midis atyre që përjetojnë infeksion SARS-CoV-2, personat e moshës 65 vjeç e lart mbeten grupmosha me rrezikun më të lartë.

Vendet duhet të përgatiten për rritje të vazhdueshme të aktivitetit të Influcencës dhe RSV gjatë javëve të ardhshme. Vaksinimi është masa më efektive për të mbrojtur kundër formave më të rënda të infeksioneve virale të frymëmarrjes. Fushatat e vaksinimit kanë filluar në shumë vende të BE/ZEE.

Burimi: <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0064%20Final.pdf>